

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr.2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, kolegji në përbërje prej gjyqtarëve, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nebojša Boričić anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

I. K., nga ..., i përfaqësuar nga Avokat, M. M. Nga ...

Kundër;

B. R., Barajevo, Serbi

Palë përgjegjëse në ankesë, /paraqitësi i kërkesës në AKP/

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/235/2014, të datës 30 Prill 2014, (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA13067), pas shqyrtimit të mbajtur me datë 29 Janar 2020, merr;

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga I. K, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/235/2014, të datës 30 Prill 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP, me numër KPA13067.**
- 2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/235/2014, i datës 30 Prill 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP, me numër, KPA13067.**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Me datë 7 dhjetor 2006, B. R., (në tekstin e mëtejshëm: pala përgjegjëse në ankesë), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP), në cilësinë ponaire, me të cilën kërkon konfirmimin e të drejtës pronësore dhe riposelimin e ngastrave kadastrale numër ..., ..., ..., ... dhe ... , me sipërfaqe prej 0.56.40ha, në vendin e quajtur, "...", komuna Kadstrale ... –Pejë.

2. Në kërkesë thekson se pronën e kërkuar e ka humbur si pasojë e konfliktit dhe se tani ajo është e uzurpuar nga A. dhe B. D. nga ... Si datë të humbjes së posedimit e cek datën 14 Qershor 1999.
3. Në mbështetje të kërkesës në AKP ka dorëzuar dokumentet në vijim;
 - Përshkrimin e Fletës poseduese nr. ..., të datës 1 Prill 1994, të lëshuar nga Zyra e Kadasrit të Pejës, në të cilën evidentohet prona e kërkuar në emër të palës përgjegjëse në ankesë;
 - Aktvendimin Nr. ..., të datës 1 Prill 1994, me të cilin mbi bazën e trashëgimisë lejohej ndryshimi në regjistrin kadastral dhe ngastrat kadastrale përfshirë edhe pronën e kërkuar evidentoheshin në emër të palës përgjegjëse;
4. Me datë 28 Maj 2010 AKP bëri publikimin e kërkesën për mes gazetës nr. 1, në Buletinin e zyrtar të UNHCR, në organet e tjera si Komuna e Pejës, Gjykatë Komunale, tek udhëheqësi i fshatit Refik Dacić, dhe organe tjera. Ne vendin e ngjarjes nuk është lejuar vënja e shenjes dhe fotografimi i pronës.
5. Me datë 29 Prill 2014, I. K. është paraqitur në AKP dhe ka pretenduar të drejtë mbi pronës e kërkuar i është drejtuar me shkrim AKP-së, i njëjti ka paraqitur në mbështetje të kërkesës keto dokumenta:
 - Autorizimin e dhënë nga D. M. për N. K. me numër Ov.Br. ... datë 28 Dhjetor 2004 certifikuar në Gjykatën Komunale në Rozhajë të Malit të Zi. Ky autorizim vlenete për ngastrën ...;
 - Para kontratë të lidhur me 1 Shkurt 2003 në mes të D. M., dhe N.K., që ka për objekt blerjen e palujtshmerisë që evidentohet në emër të D.M. si shitës pa specifikuar ngastrat vetem kulturën shtëpi banimi dhe tokë në sipërfaqe prej 75 ari.
 - Deklaratë e D. M. e dhënë në Gjykatën e Rozhajës me numër Ov.Br. ..., të datës 28 Dhjetor 2004 me të cilën deklaroi se ngastrën ... i shet V. K.
6. Sipas raportit të Konsoliduar të verifikimit të AKP-së të datës 21 maj 2013, Dokumentet e paraqitura në AKP nga pala përgjegjëse në ankesë, ishin verifikuar pozitivisht e ndër to edhe Fleta poseduese nr... dhe certifikata e pronësisë me të cilën deshmohet se prona e kërkuar ishte e evidentuar në emër të palës përgjegjëse në ankesë.
7. Me 30 Prill 2014, me vendimin e vet KKPK/D/A/235/2014, komisioni vendosi që paraqitësi i kërkesës, (pala përgjegjëse në ankesë), R..., e ka dëshmuar se është pronar i pronës së kërkuar-ngastrës kad. nr. ..., në sipërfaqe prej 1.21.78ha., dhe e ka të drejtën në posedimin e pronës së kërkuar. Në paragrafet 23 deri 25 të vendimit grupor-kapitulli, “kërkesa pronësore jo kontestuese”, (arsyet zbatohen veçanërisht për kërkesën në fjalë), theksohet se; bazuar në dëshmitë para tij komisioni gjen se paraqitësi i kërkesës ka ofruar dëshmi të mjaftueshme në mbështetje të kërkesës së tij, që e vërtetojnë se ai është pronar i pronës së kërkuar. Nga ana tjetër pretendimet e palës përgjegjëse në kërkesë nuk u mbështeten me dëshmi relevante të

cilat do të venin në pyetje të drejtën e palës kërkuese. Prandaj mbi bazën e deshmive të B. R., dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga ana e palës përgjegjëse KKPK-ja ka miratuar kërkesën.

8. Me datë 30 Shtator 2014, Vendimi i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë ndërsa vendimi i njetë, me datë 1 Tetor 2014, i është dorëzuar I. K. kurse me 29 Korrik 2015 S.K. vellau i S. K..
9. Kundër këtij Vendimi ankesë në Gjykatën Supreme ka ushtruar pala ankuese I.K., me 20 Gusht 2015.
10. Me 21 Janar 2016 i është dorëzuar një kopje e ankesës B. R. i cili pas afatit ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Pretendimet e palës ankuese

11. Pala ankuese vendimin e KKPK-së, e atakon për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljeve esenciale të ligjit të aplikueshem. Me tej ai pohon se paraardhësi i palës përgjegjëse M. R. i ka shitur tere pasurine nga lista poseduese 208, ne sipërfaqe prej 6.16.80ha., H. Sh. Ndersa ne vitin 1994, i biri i H. S. Sh. i shet D. M. ngastrën ..., me sipërfaqe prej 72 ari.
12. Pala ankuese, ankesës dhe plotësim ankesës i bashkëngjit;
 - Kopjen e kërkesë dorëzuar në Drejtoratin për Çështje Pronësore dhe Banesore për Komisionin e Kërkesave Pronësore dhe Banesore DS302838 paraqitës i kërkesës D. M. dhe objekt i kërkesës ngastra 2327.
 - Aktvendim trashigimie O.Br.17/94 date 7 Mars 1994 me te cilin pas vdekjes së M. R. tere pasuria i mbetej B. R. palës përgjegjëse në ankesë
 - Faqja e parë e kontratës e panënshkruar e pavertetuar në Gjykate, e vulosur me firmën e Avokat V. V. që nuk paraqet prove relevante,
 - Lista poseduese qe i referohet ngastrës ..., që nuk është objekt i kërkesës e as i ankesës.
 - Lista poseduese e lëshuar nga UNMIK administrara në Pejë me 29 dhjetor 2004 ku dëshmohet se prona e kërkuar gjegjësisht ngastrat kadastrale numër ..., ..., ..., ... dhe ..., evidentohen në emër të palës përgjegjëse në ankesë.
 - Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, C.Nr. 594/08, të datës 3 Prill 2014 me të cilin i njihet pronësia S. K.. mbi ngastrën ..., me sipërfaqe prej 0.53.49, dhe i paditur është B. R. dhe S. Sh.

Pretendimet e palës përgjegjëse në ankesë

13. Pala përgjegjëse në ankesë, në përgjigjen e tij të paraqitur pas afatit kohor në ankesën e palës ankuese ndër të tjera thekson se, pretendimet e palës ankuese janë të pa baza dhe se Gjykat Supreme nuk duhet ti marr në shyrtime edhe për faktin se nuk kanë relevance. Të gjitha

dëshmitë tregojnë se prona e kërkuar edhe sot evidentohet në emër të palës përgjegjëse në ankesë.

Arsyvetimi ligjor :Pranueshmëria e ankesës

14. Gjykata Supreme e Kosovës, Vendimin ankimor e shqyrtoi në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, dhe pas vlerësimit të thënieve ankimore gjeti se ankesa është e afatshme ngase është paraqitur brenda afatit ligjor sipas nenit 12.1, të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 ,ku parashihet që pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të Komisionit, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë nga njoftimi i palëve për vendimin.
15. Sa i përket pranueshmërisë së ankesës, edhe pse sipas nenit 10.2, të Ligjit nr. 03/L-079 parashihet se çdo person tjetër për pos paraqitësit të kërkesë i cili aktualisht pretendon mbi pronën e kërkuar do të jetë palë në kërkesë dhe procedurë lidhur me ate kërkesë me kusht që personi i tillë të informoj AKP-në për synimet e tij ose të saj që të merr pjesë në procedurë, dhe sipas nenit 12.1 të njëjtit ligj brenda 30 dite të paraqes ankesë kundër vendimit të KKPK-së.
16. Edhe pse fillimisht pala ankuese kishte refuzuar të nënshkruaj formularin e pjesë marrjes në këtë procedurë megjithatë i njëjti i ishte drejtuar AKP-së me kërkesë, duke shprehur interes ligjor për pronën e kërkuar sipas të cilave parashtresa thekson se e ka blerë pronën në një transaksion joformal e më pas ka inicuar procedurë në gjykatë për vërtetim të pronësië .

Meritat e ankesës;

17. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të palës ankuese dhe palës përgjegjëse në përgjigjen në ankesën e palës ankuese, gjykata supreme megjithatë gjen se ankesa është e pabazuar, ndërsa vendimi i KKPK-së është i drejtë dhe ligjor. Gjykata nuk gjen prova se Vendimi i ankimuar është i përfshirë me mos vërtetimin jo të plotë apo të gabuar të fakteve lidhur me gjendjen faktike, ashtu si thekson pala ankuese në ankesë dhe plotësim ankese, e as me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale.
18. Sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë, ndërmjet 27 Shkurtit 1998 dhe 20 Qershorit 1999.
19. Pasi që paraqitësi e kërkesës e cek se data e humbjes së posedimit në pronën e kërkuar është Qershori i vitit 1999, kërkesa ka të bëjë me rrethanat që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me, apo rezultojnë nga konflikti i armatosur në Kosovë dhe me që i njëjti e ka dëshmuar të drejtën e tij pronësore dhe nuk është dëshmuar se prona e kërkuar është shitur, nga këto fakte kërkesa e tij nga KKPK-ja, me të drejtë është vendosur në favor të tij.

20. Gjykata Supreme pajtohet me vendimin e KKKP-së, se pala ankuese, përderisa pretendon të drejtë ligjore ndaj pronës kontestuese, nuk ka paraqitur dokumentacion apo ndonjë informacion tjetër valid në mbështetje të drejtës së tij, as në kohën e njoftimit të pronës, apo gjer në vendosje në shkallën e parë nga KKKP dhe as tani me ankesë, përkundër faktit se atij i është dhënë një mundësia e tillë për ta dëshmuar të drejtën e tij.
21. I njëjti për veç se është deklaruar deklarativisht për mes parashtresave me shkrim në shkallën e parë, si edhe tani në ankesë, se pronën e kërkuar e ka blerë nga pala përgjegjëse në ankesë dhe familjarët e tij, duke e cekur edhe shumën e çmimit blerës të pronës në të cilën ka ndërtuar shtëpi, nuk ka ofruar asnjë dëshmi me vlerë juridike, që do të argumentonin një transaksion të tillë të shitblerjes së pronës kontestuese. Te gjitha dëshmitë e paraqitura i referohen ngastrave tjera e jo atyre që kerkohen dhe janë objekt shqyrtimi i kërkesës dhe snkesës.
22. Lidhur me pretendimet në ankesë, se dëshmitarët të cilët i cek e din që pronën e kërkuar e ka blerë, të cilët mund të deklarohen në çdo rast dhe të dëshmojnë për transaksionin e shitblerjes, kolegji i gjykatës supreme i vlerëson po ashtu si jo të qëndrueshme apo me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje, sepse deklarimet eventuale të dëshmitarëve nuk do të ishin mbrojtje valide dhe nuk janë dokumente në bazë të cilave dëshmohet pronësia, gjer sa në anën tjetër të dhënat kadastrale dëshmojnë se prona kontestuese është e evidentuar në emër të palës përgjegjëse në ankesë dhe bashkëpronarëve –familjareve të tjerë të tij.
23. Bazuar në legjislacionin në fuqi konkretisht nenit 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (GZ RSFJ, Nr.6/80) përcaktohet se, në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në regjistrat publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj. Edhe Ligji aktual nr. 03/l-154, Për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, në nenin 36 pika 1, e parasheh se “Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit, si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri”, ndërsa është evidente dhe e vërtetuar se në çështjen në shqyrtim nuk dëshmohet me asnjë provë relevante se ka ndodhur një transaksion valid me një punë juridike ligjore, lidhur me pronën kontestuese në mesë të palës ankuese dhe palës përgjegjëse.
24. Sipas nenit 12.11 të Ligjit 03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 , faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesë, nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme, përpos nëse dëshmohet se faktet dhe dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë. Bazuar në këtë dispozitë ligjore, pala ankuese në ankesë, plotësim ankese dhe njoftim, nuk ka ofruar asnjë dëshmi materiale me vlerë juridike, për veç se thirret në prova dhe deklarata të njëjta të paraqitura edhe më parë, ndërsa nuk është me peshë juridike as njoftimi që e ofron lidhur me padinë e paraqitur në gjykatë të rregullt nga pala përgjegjëse në ankesë, me të cilën ka kërkuar ti lirohet prona e tijë e uzurpuar, sepse edhe sipas vendimit të ankimuar si në paragraf

23-25 të vendimit individual parashihet se pala e cila e ka uzurpuar pronën lëndore, duhet ta liron në afatin prej 30 ditë nga dita e pranimit të vendimit dhe nëse nuk e liron në afatin e caktuar do të dëbohet nga prona.

25. Nga faktet e lartpërmendura rezulton se gjendja faktike në këtë çështje juridike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë andaj konfirmimi i vendimit të KKPK-së, nuk është sjellë në dyshim nga theksimet në ankesë, sepse nuk bazohen në asnjë provë të vlefshme juridike.
26. Ky Aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palëve në procedurë që t'i kërkojnë të drejtat e tyre para gjykatave të rregullta në Kosovë nëse e gjejnë të arsyeshme.
27. Në bazë të lartcekurave dhe në lidhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079 , Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm andaj nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
GSK-KPA-A-071/16, me datë 29 Janar 2020

Bashkp. Profesional
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani